

20260110183

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT TË REGJISTRIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM SOCIAL

Neni 1

Në Ligjin e Sigurimit të Detyrueshëm Social ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 209/23), në nenin 4, pika 10, fjalët: "Ministria e Punës dhe Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe e të Rinjve", fjalët: "Ministria e Kulturës" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Kulturës dhe Turizmit", fjalët: "Agjencia për Rini dhe Sport" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Sportit", dhe fjala "përkatësisht" shlyhet.

Në pikën 11, fjalët: "Ministria e Drejtësisë - Drejtoria e Udhëheqjes së Librave të Amzës" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Transformimit Digjital - Drejtoria e Udhëheqjes së Librave të Amzës", dhe fjalët: "Ministria e Shoqërisë Informatike dhe e Administratës" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Transformimit Digjital".

Neni 2

Neni 10 ndryshohet si vijon:

"(1) Drejtori i Drejtorisë është i detyruar për ministrin e Politikës Sociale, Demografisë dhe të Rinjve të dorëzojë për miratim planin vjetor për punën e Drejtorisë, më së voni deri më 1 dhjetor të vitit aktual për vitin vijues, raportin gjashtëmujor për punën e Drejtorisë, më së voni deri më 31 korrik dhe raport vjetor për punën e Drejtorisë më së voni deri më 31 janar për vitin paraprak.

(2) Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe e të Rinjve, raportin vjetor mbi punën e Drejtorisë nga paragrafi (1) i këtij neni, pas miratimit të tij, ia paraqet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shqyrtim dhe miratim."

Neni 3

Në nenin 11, në paragrafin (1) fjalët: "Ministria e Punës dhe Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe e të Rinjve".

Neni 4

Në nenin 13, paragrafi (5) në pikën 5. pas fjalëve "së paku niveli B2 (B2)" shtohen fjalët: "ose posedon certifikatë ose vërtetim me të cilat vërtetohet njohja e njërës prej tre gjuhëve më të përdorura të Bashkimit Europian - (anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht) me së paku në nivelin B2 (B2), të Kornizës Europiane të Referencës për Gjuhët, të lëshuar nga një institucion në shtet ose jashtë vendit, të regjistruar si ofrues i këtij shërbimi."

Neni 5

Në nenin 15, paragrafi (1), pas pikës 5. lidhëza "ose" zëvendësohet me pikë-presje.

Në pikën 6, pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën "ose".

Pas pikës 6. shtohet pikë e re 7. si vijon:

"7. nëse raporti gjysmëvjetor ose vjetor mbi punën e Drejtorisë nuk është miratuar për shkak të qëllimeve të parealizuara të përcaktuara në planin vjetor të punë nga neni 10, paragrafi (1) i këtij ligji."

Neni 6

Në nenin 19 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Përmbajtja e RSDS-së, me propozim të drejtorit të Drejtorisë, do të përcaktohet më hollësisht nga ministri."

Neni 7

Në nenin 20, paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"Regjistrimi, përkatësisht aplikimi, ndryshimi dhe çregjistrimi i një subjekti që merr pjesë në sistemin e sigurimit të detyrueshëm social në RSDS kryhet nga një agjent regjistrimi, në emër të tij ose në bazë të autorizimit të marrë nga personi fizik ose juridik, në emër dhe për llogari të të cilit kryhet regjistrimi në përputhje me nenin 22 të këtij ligji."

Neni 8

Në nenin 21, paragrafi (10) ndryshohet si vijon:

"Përmbajtja e formularëve të regjistrimit, struktura e numrit të vetëm të regjistrimit, si dhe standardet teknike për qasjen dhe përdorimin e RSDS-së, do të përcaktohen më hollësisht nga Ministri."

Neni 9

Në nenin 22, paragrafi (1), pika 3, pas shkurtesës "RSDS", do të shtohen fjalët: "bazuar në autorizimin e marrë nga personi fizik ose juridik, në emër dhe për llogari të të cilit kryhet regjistrimi".

Paragrafët (7) dhe (8) shlyhen.

Paragrafi (9) bëhet paragraf (7).

Neni 10

Në nenin 23, paragrafi (1), në fjalinë hyrëse, fjalët: "Ministria e Punës dhe Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalën "Ministria".

Në pikën 12, fjalët: "Ministria e Punës dhe Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalën "Ministria".

Në paragrafin (2) fjalët: "Ministria e Kulturës" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Kulturës dhe Turizmit".

Paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

"Ministria e Sportit është agjenti i regjistrimit për sportist të nivelit të lartë që ka fituar një status të tillë sipas kriterëve, në një procedurë të përshtatshme dhe me një akt të përshtatshëm të Ministrisë së Sportit."

Neni 11

Në nenin 24, paragrafi (1), pika 6, pas fjalës "drejtues", shtohen fjalët: "për detyruesin e pagesës, i punësuar nga debitori të cilin ai e përfaqëson dhe paraqet, në përputhje me ligjin".

Pika 7. ndryshohet si vijon:

"i punësuar në agjenci private për punësim, e cila në përputhje me ligjin kryen punësim të përkohshëm dhe/ose ndërmjetësim punësimi me pagesë;"

Në paragrafin (2) fjalët: "i cili performon për një klub sportiv dhe merr pjesë në një sistem garash" zëvendësohen me fjalët: "në përputhje me ligjin".

Neni 12

Në nenin 25, paragrafi (1), në pikën 2. pas fjalëve "marrëdhënie pune ose" shtohet fjala "në", fjala "nëse" zëvendësohet me fjalën "përderisa" dhe pas fjalës "Maqedoni" fshihet presja dhe fjala "nëse".

Në paragrafin (2) pika 8. ndryshohet si vijon:

"në ngjarje sportive si sportistë amatorë në përputhje me Ligjin e Sportit dhe".

Neni 13

Në nenin 27, paragrafi (1) në pikën 1. fjalët: "Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës" zëvendësohen me fjalët: "Ministria e Transformimit Digjital".

Në pikën 4, fjalët: "Ministria e Punës dhe Politikës Sociale" zëvendësohen me fjalën "Ministria".

Pas paragrafit (3), shtohet paragraf i ri (4) si vijon:

"(4) Çdo institucion përgjegjës për sigurimin e detyrueshëm social dhe institucion tjetër i përfshirë në sistemin e sigurimit të detyrueshëm social duhet të shkëmbejë me RSDS vetëm ato të dhëna nga neni 19 i këtij ligji për të cilat është burimi i të dhënave."

Paragrafi (4) bëhet paragraf (5).

Paragrafi (5), i cili bëhet paragrafi (6) ndryshohet si vijon:

"(6) Në rast se ka një mospërputhje ndërmjet të dhënave në RSDS dhe të dhënave nga institucione të tjera që janë burimet e këtyre të dhënave, të dhënat do të përditësohen automatikisht në RSDS."

Paragrafi (6), i cili bëhet paragrafi (7) ndryshohet si vijon:

"(7) Në rast se ka mospërputhje në të dhënat e përmbajtura në institucione ose subjekte të tjera, dhe burimi i këtyre të dhënave është RSDS, gjenerohet një njoftim për institucionin ose subjektin tjetër në lidhje me nevojën për të përditësuar të dhënat."

Paragrafët (7) dhe (8) bëhen paragrafët (8) dhe (9).

Neni 14

Në nenin 28, paragrafi (2), lidhëza "ose" zëvendësohet me presje, dhe pas fjalës "punë" shtohen fjalët: "ose një organi tjetër kompetent inspektues".

Paragrafi (3) ndryshohet si vijon:

"(3) Një gabim teknik gjatë futjes së të dhënave në RSDS mund të ndryshohet pa vendim gjykatë, një akt të Inspektoratit Shtetëror të Punës ose një organi tjetër kompetent inspektues, jo më vonë se tetë ditë nga dita e futjes së të dhënave për regjistrim ose çregjistrim në sigurimin e detyrueshëm social."

Në paragrafin (7), pas fjalës "RSDS", shtohen fjalët: "si dhe përcaktimi i llojeve të gabimeve teknike gjatë futjes së të dhënave në RSDS nga paragrafi (3) i këtij neni".

Neni 15

Në nenin 33, në paragrafin (1), pas pikës, shtohet një fjali e dytë, e cila thotë: "Personi i siguruar ka të drejtë të njoftohet për çdo ndryshim të bërë në të dhënat e tij në RSDS".

Në paragrafin (3), pas fjalës "kërkesë", vendoset një presje dhe shtohen fjalët: "personalisht ose".

Neni 16

Në nenin 34, në paragrafin (1) pas fjalës "rrugë" shtohen fjalët: "personalisht ose".

Neni 17

Në nenin 35, paragrafi (1), në pikën 8. fjalët: "ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës" zëvendësohen me fjalët: "ministri i Transformimit Digjital".

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"(2) Trupi punues nga paragrafi (1) i këtij neni kryen detyrat e mëposhtme:

1. monitoron dizajnimin, zbatimin dhe optimizimin e vazhdueshëm të RSDS-së;
2. ofron propozime për ndryshime dhe përmirësime në proceset dhe funksionalitetet e RSDS-së për Drejtorinë dhe institucionet e tjera kompetente;

3. monitoron procesin e gjenerimit dhe pastrimit të të dhënave;
- . monitoron ndryshimet në rregullore dhe akte të tjera që lidhen me punën e RSDS-së dhe merr pjesë në përgatitjen e propozimeve për ndryshime në rregullore dhe akte të tjera;
5. merr pjesë në krijimin e proceseve të biznesit për zbatimin e rregulloreve dhe
6. kryen aktivitete të tjera profesionale që lidhen me funksionimin e RSDS-së.”

Paragrafi (4) ndryshohet si vijon:

“(4) Ministri mund të angazhojë persona të tjerë në Trupin Punues për të ofruar mbështetje në kryerjen e punës së Trupit Punues të përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni.”

Në paragrafin (7) fjalët: "tejkalon shumën e gjysmës" zëvendësohen me fjalët: "arrin më shumë se 20%”.

Neni 18

Në nenin 38, paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

"(1) Mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji kryhet nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Inspektorati Shtetëror Administrativ, secili brenda kuadrit të kompetencës së përcaktuar në nenin 39 të këtij ligji."

Neni 19

Neni 39 ndryshohet si vijon:

"(1) Mbikëqyrja inspektuese nga neni 38, paragrafi (1) të këtij ligji, e cila zbatohet nga Inspektorati Shtetëror i Punës, përfshin mbikëqyrjen mbi subjektet që marrin pjesë në sistemin e sigurimit të detyrueshëm social në lidhje me regjistrimin dhe çregjistrimin në sigurimin e detyrueshëm social të punëtorëve dhe personave të tjerë në përputhje me rregulloret në fushën e marrëdhënieve të punës, punësimit dhe sigurisë në punë.

(2) Mbikëqyrja inspektuese nga neni 38, paragrafi (1) të këtij ligji, e cila zbatohet nga Inspektorati Shtetëror Administrativ, përfshin mbikëqyrjen mbi ushtrimin në kohë, ekonomik dhe efikas të së drejtës së qytetarëve dhe subjekteve të tjera që marrin pjesë në sigurimin e detyrueshëm social të të dhënave të tyre të përmbajtura në RSDS."

Neni 20

Neni 40 ndryshohet si vijon:

“Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese nga neni 38, paragrafi (1) të këtij ligji, inspektorët vendosin masa inspektuese për të eliminuar parregullsitë dhe mangësitë e identifikuara në përputhje me Ligjin e Mbikëqyrjes Inspektuese.”

Neni 21

Neni 41 ndryshohet si vijon:

“(1) Gjobë në shumë prej 2.000 deri 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t’ju shqiptohet për kundërvajtje subjekteve të cilat marrin pjesë në sistemin e sigurimit të detyrueshëm social në lidhje me regjistrimin dhe çregjistrimin në sigurimin e detyrueshëm social të punëtorëve dhe personave të tjerë në përputhje me rregullat nga sfera e marrëdhënieve të punës, punësimit dhe mbrojtjes gjatë punës, nuk i rruajnë të dhënat e lidhura me sistemin e sigurimit të detyrueshëm social (neni 29 paragrafi (3)).

(2) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit udhëheqës të Drejtorisë, nëse nuk e mban RSDS (neni 31 paragrafi (2)).

(3) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë me denarë do t’i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik nëse nuk i vendos dhe nuk i mban standardet e vetme teknike - teknologjike dhe proceset për qasje në RSDS (neni 31, paragrafi (3)).

(2) Gjohë në shumë prej 600 deri 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse nuk i vendos dhe nuk i mban standardet e vetme teknike - teknologjike dhe proceset për qasje në RSDS (neni 31, paragrafi (3)).

Neni 22

Për qëllim të krijimit të RSDS-së, institucionet përgjegjëse për sigurimin e detyrueshëm social dhe institucionet e tjera të përfshira në sistemin e sigurimit të detyrueshëm social që nuk i kanë dorëzuar bazat e të dhënave të tyre deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë të detyruara t'i dorëzojnë të dhënat nga bazat e tyre të të dhënave Ministrisë në formë elektronike dhe të koduar, brenda 30 ditëve nga dita e marrjes së kërkesës nga Ministria për dorëzimin e të dhënave.

Neni 23

Në tërë tekstin e Ligjit fjalët: “numri i vetëm i amzës së qytetarit” zëvendësohen me fjalët: “numri i amzës së qytetarit”, ndërsa shkurtesa “(NVAQ)” zëvendësohet me shkurtesën “(NAQ)”.

Neni 24

Dispozita nga neni 17 i këtij ligji, me të cilën ndryshohet neni 35, paragrafi (7) i Ligjit të Regjistrimit të Sigurimit të Detyrueshëm Social (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 209/23), do të fillojë të zbatohet nga 1 korriku 2026.

Neni 25

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.